



**Republika e Kosovës**  
**Komuna e Drenasit (Glllogoc)**  
**Kuvendi i Komunës**

02 Nr. 03061.16028 dt. 29.03.2024



Bazuar në nenin 11,12,dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, Memorandumit të Bashkëpunimit të datës 27.12.2023 për transferimin nga Komuna në Agjencinë pyjore të stafit të Pylltarisë, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.03.2024, miratoi këtë:

## **V E N D I M**

**Për plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës së Drenasit lidhur me emertimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e DBPZHR**

### **Neni 1**

Me këtë vendim behët plotësim ndryshimi i Statutit të Komunës së Drenasit sa i përket nenit 85 duke e riformuluar emërtimin e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural si dhe duke modifikuar kompetencat dhe përgjegjësitë e kësaj Drejtorie.

### **Neni 2**

Sipas Memorandumit të bashkëpunimit për transferimin nga Komuna në Agjencinë pyjore të stafit të Pylltarisë, të datës 27.12.2023 gjithashtu të formohet Komisioni i cili do të këtë për detyrë të bëjë riformulimin e emertimit të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural si dhe të modifikoj kompetencat dhe përgjegjësitë e kësaj Drejtorie.

### **Neni 3**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

  
**Miralim Hajdari**

## ARSYETIM

Me datë 27.12.2023 Komuna e Drenasit ka lidhur Memorandum të bashkëpunimit me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit lokal për transferimin nga Komuna e Drenasit në Agjencinë Pyjore të Kosovës të stafit të Pylltarisë, rojeve të pyllit, teknikeve të pylltarisë, përgjegjësive të njësive komunale etj bashkë me mjetet buxhetore përkatëse, automjetet dhe pajisjet e tjera si dhe mjetet tjera përkatëse funksionale që lidhen me përgjegjësitë dhe detyrat e ndryshme pyjore. Andaj duke marrë parasysh Memorandumin e lartëcekur dhe faktin se stafi i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural tashmë ka kaluar në Agjencinë Pyjore të Kosovës përmes këtij dokumenti propozohet që në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda kometencave të veta Kuvendi i Komunës të aprovoj Propozimin Vendimin Për plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës së Drenasit duke e riformuluar emërtimin e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural si dhe si dhe të formohet Komisioni i cili do të këtë për detyrë modifikojë kompetencat dhe përgjegjësitë e kësaj Drejtorie.